

## ALIU NË KUR'AN

### SEJJID TEKIJ JUSUF EL-HAKIJM

Ajeteve të komentuara për Ehli Bejtin u shtohen shumë ajete të cilat sqarojnë përparësinë, pozitën, tiparet dalluese, moralin e bukur të prijësit të besimtarëve, Imam Aliut (*paqja qoftë mbi të!*), si dhe domosdoshmërinë e bindjes ndaj tij. Ato janë të shumta dhe prelati i ummetit, Ibn Abbasi, i përshkruan ato me thënien e tij: “Nuk ka zbritur për njeri në Librin e Allahut të Lartësuar, çfarë ka zbritur për Aliun.”<sup>1</sup>

Gjithashtu ka thënë: “Në çdo ajet në Librin e Allahut që thotë: **“O ju, të cilët keni besuar!”**, Aliu është i pari, prijësi dhe fisniku i tij. Edhe pse i ka qortuar Allahu as’habët (bashkëkohësit) e Muhamedit, Ai nuk e ka përmendur Aliun, veçse për mirë.” Këtë e ka transmetuar Taberani dhe Ibn Ebi Hatemi nga Ibn Abbasi.<sup>2</sup>

Duke parë ajetet e shumta që kanë zbritur për të, muhadithët dhe komentuesit e shkruar i kanë dhënë rëndësi individualizmit të tematikës për ato që kanë zbritur në Kur’an për Aliun me përshkrime e botime, si p.sh.: Xheludiju, Taberani, Ebu Naimi, Muhamed ibn Mu’mini Shiraziju, Hasekaniju, Ebu’l Ferexh El-Isfahani, Hibriju, Merzebaniju, Ebu Is’hak Eth-Thekafiju, Ebu Xha’fer El-Kummiju, El-Muxhashiiju, Ebu Abdil’lah El-Khurasaniju e të tjerë.<sup>3</sup>

Siç vijon, po përmendim një përzgjedhje të ajeteve të Kur’anit që kanë zbritur, veçanërisht, në lidhje me udhëheqësinë e prijësit të besimtarëve, Ali ibn Ebi Talibit:

**1- Allahu i Madhëruar thotë: “...Sot përsosa për ju fenë tuaj, plotësova ndaj jush dhuntinë Time dhe zgjodha për ju Islamin si fe...”**<sup>4</sup>

{...الْيَوْمَ أَكْمَلْتُ لَكُمْ دِينَكُمْ وَأَتَمَمْتُ عَلَيْكُمْ نِعْمَتِي وَرَضِيْتُ لَكُمُ الْإِسْلَامَ دِينًا...}

Ky ajet ka zbritur për udhëheqësinë e prijësit të besimtarëve. Transmetimet me zinxhir të saktë, të cilat bëjnë të qartë zbritjen e këtij ajeti të Dërguarit të Allahut pas kthimit nga Haxhi i Lamtumirës dhe gjatë ligjëratës në Gadijrin Khum, mbështesin njëra-tjetrën.

Kjo është vërtetuar nga metoda të shumta të transmetuesve të besueshëm, që kanë transmetuar nga një numër i madh sahabësh (shokësh). Prej tyre: Ali ibn Ebi Talibi,

<sup>1</sup> *Tarijkhul-Khulefa* i Sujutijut, 189, Daru’t-Te’au, Mekke Mukerremeh. *Nuru’l-Ebsar*, 90.

<sup>2</sup> *Nuru’l-Ebsar*, 87 dhe 90. *Kifajetu’t-Talib*, 139. *Er-Rijadu’n-Nadire*, 2: 274. *Dhekhairu’l-Ukba*, 389. *Mexhmau’z-Zeuaid*, 1: 317 dhe 9: 112. Biografia e Imam Aliut nga *Tarijkhul Medijneti Dimashk*, 2: 428-430/935-939. *Shevahidu’t-Tenzil*, 1: 48-54/ 67-85. *Menakibu’l-Khavarizmij*, 188.

<sup>3</sup> *Ehlu’l-Bejt fi’l-Mektebeti’l-Arabije* i Abdul Azijz Et-Tabatabaij, 444-445, Muessesetu Ali’l-Bejt li Ihjai’t-Turath, Kum botimi 1. *Edh-Dherij’ah ila Tesanijfi’sh-Shi’a* i Aga Buzurg Et-Tahrani, 19: 28-29, Menshurat Ismailijjan, Kum. *En-Nuru’l-Mushte’al min Kitab Ma Nezele mine’l-Kur’an fi’-Imami Alij* i Ebu Naim El-Asbehanit, 14-19, Ministria e Udhëzimit Islam, Kum, botimi 1.

<sup>4</sup> Surja “El-Maide”, ajeti 3.

Abdullah ibn Abbasi, Ebu Said El-Khudriju, El-Bera ibn 'Azibi, Zejd ibn Erkami, Selman Farisiju, Ebu Dherr El-Gifarij, Ammar ibn Jasiri, Mikdad ibnu'l-Esuedi dhe Ebu Hurejreja.<sup>5</sup>

Në atë ligjëratë thuhet se Profeti, ditën që i ftoi njerëzit në Gadijr Khum ka qenë ditë e enjte, më pas i ftoi njerëzit për tek Ali ibn Ebi Talibi.

Ndërkohë, mori dorën e tij dhe ngriti atë deri sa njerëzit panë të bardhën e pëllëmbës dhe tha: *“Për atë që kam qenë udhëheqës i tij edhe Aliu është udhëheqësi i tij. O Allah i Plotpushtetshëm, duaje atë që që e do Aliun dhe bëhu armik i atij që armiqëson Aliun. Përkrahe atë që përkrah Aliun dhe poshtëroje atë që e poshtëron Aliun.”* Pastaj ata të dy nuk u ndanë derisa zbriti ky ajet: **“Sot përsosa për ju fenë tuaj...”** I Dërguari i Allahut tha: *“Allahu është më i Madhi ndaj përsosjes së fesë, plotësimit të begative dhe kënaqësisë së Tij me mesazhin tim dhe udhëheqjen e Aliut.”*<sup>6</sup>

Poeti i të Dërguarit të Allahut, Hasan ibn Thabit El-Ensarij e ka regjistruar këtë ngjarje historike me fjalë të ndritura. Pasi i mori leje të Dërguarit të Allahut e ky i fundit i dha leje atij, Hasani tha:

*“Profeti i tyre i thërret ata në Khum atë Ditë Gadijri,  
dhe sa duhej dëgjuar i Dërguari kur thirri!  
Tha: ‘Cili është i pari juaj dhe i juaj kujdestar?’  
Ata u përgjigjën – pa pipëtirë ndonjë kundërshtar - :  
Ti je udhëheqësi ynë dhe i yni kujdestar  
dhe nuk do të gjesh ti sot tek ne asnjë kundërshtar.’  
I tha atij: ‘Çohu, o Ali, sepse unë  
të kam pëlqyer ty pas meje udhëzues e prijëtar.  
Për atë që kam qenë udhëheqës, ky është i tiji udhëheqës  
Jini për të përkrahës besnikë dhe ndjekës.’  
E atëherë, u lut: ‘O Allahu im, duaje të tijn ashik  
dhe bëhu armik i atij që i bëhet Aliut armik.”*<sup>7</sup>

Në fillim të një kasideje të prijësit të besimtarëve (paqja qoftë mbi të!) shkruhet:

*“Muhamedi, Profeti, vëllai dhe binjaku im*

<sup>5</sup> Shih *Menhexh fi'l-Intimai'l-Medhhebij* i Prof. Saib Abdu'l-Hamijid, 148, Merkezu'l-Gadijri, Kum, botimi 5.

<sup>6</sup> Shih *Menakibu'l-Khavarizmij*, 80. *Maktelu'l-Imami'l-Hysejn* po i tiji, 47. *Terxhemetu'l-Imami Alij* i Ibn Asakirit, 2: 75/577-580. *Tarijku Bagdad*, 8: 290. *Tarijku'l-Ja'kubij*, 2: 43. *Shevahidu't-Tenzijl*, 157/210-215. *El-Menakib* i Ibnu'l-Megazilit, 19. *Tedhkiretu'l-Khauass* i Ibnu'l-Xheuzijit, 29. *Feraidu's-Simtejn*, 1: 315. *Ed-Durru'l-Menthur* i Sujutijut, 2: 259. *El-Itkan* po i Sujutijut, 1: 75.

<sup>7</sup> *El-Irshad* i Shejh Mufidit, 177, Muessesetu Ali'l-Bejt, Kum botimi 1. *El-Fusulu'l-Mukhtare* i Shejkh Mufijdit, 209 dhe 235, Mektebetu'd-Dauerij, Kum, botimi 4. *El-Emalij* i Sadukut, 460/3. Mexhlisi 84. *El-Menakib* i El-Khavarizmijut, 80. *Maktelu'l-Imami'l-Hysejn* gjithashtu i Khavarizmijut, 2: 47. *Tedhkiretu'l-Khauass* i Ibnu'l-Xheuzijut, 33. *El-Menakib* i Ibn Shehr Ashubit, 3: 27. *Kenzu'l-Feuaid* i El-Keraxhikijut, 1: 268, Daru'l-Edua, Bejrut. *Keshfu'l-Gummeh* i El-Irbilijut, 1: 319. *A'lamu'l-Uera* i Tabrasij, 1: 262. *Et-Taraif* i Ibn Tausit, 146. *Kifajetu't-Talib*, 64. *Feraidu's-Simtejn*, 1: 73-74. Dhe e ka transmetuar Al'lame Eminij në *El-Gadijri*, 2: 34 në 38 rrugë.

e Hamzai, zotëria i dëshmorëve, xhaxhai im...”

e deri te thënia e tij (paqja qoftë mbi të!):

“E obligoi udhëheqësinë time për ju  
i Dërguari i Allahut Ditën e Gadijrit Khum  
Mjerë për atë, pastaj mjerë për atë, pastaj mjerë për atë  
që e takon Zotin nesër me padrejtësi ndaj meje!”<sup>8</sup>

**2- Allahu i Madhëruar thotë: “O ti, i Dërguar! Komunikojë atë që t’u zbrit prej Zotit tënd, e nëse nuk e bën, atëherë nuk e kryer misionin e Tij. Allahu të garanton mbrojtjen prej njerëzve...”**<sup>9</sup>

{ يَا أَيُّهَا الرَّسُولُ بَلِّغْ مَا أُنزِلَ إِلَيْكَ مِنْ رَبِّكَ وَإِنْ لَمْ تَفْعَلْ فَمَا بَلَّغْتَ رِسَالَتَهُ وَاللَّهُ يَعْصِمُكَ مِنَ النَّاسِ... }

Ky ajet ka zbritur për udhëheqësinë e Prijësit të besimtarëve dhe me të njëjtin rast që zbriti edhe ajeti i parë. Ka transmetuar El-Uahidiju me zinxhir nga Ebi Sa’id El-Khudrij, i cili ka thënë: “Ky ajet ka zbritur në ditën e Gadijr Khumit (fill pas Haxhit të Lamtumirës) për Ali ibn Ebi Talibin.”<sup>10</sup>

Transmeton Sujutiju dhe Sheukaniju nga Ibn Mes’udi, i cili ka thënë: “Lexonim në kohën e të Dërguarit të Allahut: “O ti, i Dërguar! Komunikojë atë që t’u zbrit prej Zotit tënd” që Aliu është udhëheqësi i besimtarëve: “E nëse nuk e bën, atëherë nuk e kryer misionin e Tij.”<sup>11</sup>

**3- Allahu i Madhëruar thotë: “Udhëheqësi (kujdestari) juaj është Allahu, i Dërguari i Tij dhe besimtarët që falin namazin dhe japin zeqatin, duke qenë të përlulur (në adhurim - ruku’).”**<sup>12</sup>

{ إِنَّمَا وَلِيُّكُمُ اللَّهُ وَرَسُولُهُ وَالَّذِينَ آمَنُوا الَّذِينَ يُقِيمُونَ الصَّلَاةَ وَيُؤْتُونَ الزَّكَاةَ وَهُمْ رَاكِعُونَ }

Ky ajet, gjithashtu, ka zbritur për udhëheqjen e prijësit të besimtarëve.

Shumica e librave të komentimit (tefsijr) të Kur’anit vërtetojnë zbritjen e këtij ajeti për Ali ibn Ebi Talibin (paqja qoftë mbi të!) në momentin që dha unazën e tij për sadaka duke qenë në ruku’ të namazit.<sup>13</sup>

<sup>8</sup> Kenzu’l-Feuaid i El-Keraxhikij, 1: 266. Tedhkiretu’l-Khauass i Ibnu’l-Xhevziijit, 102. El-Ihtixhaxh i Tabrasijit, 180. El-Fusulu’l-Muhimmeh i Ibn Sabbagut, 32. Raudatu’l-Ua’idhijn, 87. Kenzu’l-Ummal, 13: 112. Mukhtesaru Tarijkhi Dimashk i Ibn Mendhurit, 18: 77. Dhe e ka transmetuar Al’lame Emijnij në El-Gadijr, 2: 25 në 37 rrugë.

<sup>9</sup> Surja “El-Maide”, ajeti 67.

<sup>10</sup> Esbabu’n-Nuzul, 115.

<sup>11</sup> Ed-Durru’l-Menthur, 2: 298. Fet’hu’l-Kadijr i Sheukanijit, 2: 60.

<sup>12</sup> Surja “El-Maide”, ajeti 55.

<sup>13</sup> Esbabu’n-Nuzul i El-Uahidijit, 3: 114. Lubabu’n-Nukul fi Esbabi’n-Nuzul i Sujutiut, 81. Tefsijru Ebi’s-Su’ud, 3:52. Tefsijru’l-Kesh’shaf i Zemakhsherijut, 1: 649. Me’alimu’t-Tenzijl i Begavijut, 2: 272. Xhamiu’l-Usul i Xhezerijut, 8: 664/6515 dhe botime të tjera rreth viryeteve e komentimeve.

Kuptimi i udhëheqësit në këtë ajet nuk del nga kuptimi që të shkon në mendje, që është posedues i urdhrit, i çështjes dhe më parësor në udhëheqje. Pra, kuptimi është për atë që ka kompetencën e udhëheqjes për çështjet e njerëzve dhe që ka më shumë përparësi mbi to, është imami, prijësi; është një tekst deklarativ e i qartë për prijësinë e prijësit të besimtarëve, pas të Dërguarit të Allahut (*paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Hasan ibn Thabiti, në lidhje me këtë kuptim, kompozoi:

*“O Ebu’l-Hasan flijoj për ty veten dhe jetën time  
e çdo i ngadaltë në udhëzim e i shpejtë  
A mund të shkojë dëm lavdërimi im dhe i të dashuruarve  
Lavdërimi në krahët e Zotit nuk humbet  
Ti je ai që dhe duke qenë në ruku (i përulur në namaz)  
U flijofshin për ty shpirtrat e popullit, o i përuluri më i mirë  
Për ty Allahu zbriti prijësinë më të mirë  
dhe e sqaroi atë në ligjet e patundshme.”<sup>14</sup>*

**4- Allahu i Madhëruar thotë: “Dhe tërhiqju vërejtjen farefisit tënd më të afërt.”<sup>15</sup>**

{وَأَنْذِرْ عَشِيرَتَكَ الْأَقْرَبِينَ}

Në librat e komentimit të Kur’anit dhe historisë së Profetit, në lidhje me shkakun e zbritjes së këtij ajeti, thuhet se i Dërguari i Allahut (*paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) thërriti fisin Abdu’l-Muttalib, u dha për të ngrënë e më pas iu drejtua duke u thënë: *“O bijtë e Abdu’l-Muttalibit! Beto hem në Allahun se nuk njoh ndonjë të ri mes arabëve që i ka sjellë popullit të tij diçka më të mirë se ç’ju kam sjellë unë juve. Unë ju kam sjellë më të mirën e kësaj bote dhe botës tjetër. Më urdhëroi Allahu i Lartësuar që t’ju ftoj juve për tek Ai. Cili nga ju më përkrash mua në këtë çështje që të jetë vëllai im, këshilltari im dhe zëvendësi im tek ju?”* Të gjithë të pranishmit heshtën dhe nuk thanë asgjë. Aliu (*paqja qoftë mbi të!*) tha: *“Unë, o i Dërguari i Allahut, do të jem përkrashësi yt për të.”* Pastaj Profeti e kapi për qafe e tha: *“Me të vërtetë, ky është vëllai im, këshilltari im dhe zëvendësi im tek ju, kështu që dëgjojeni atë dhe binduni atij.”<sup>16</sup>*

Ajetet që kanë zbritur për prijësin e besimtarëve, Aliun, janë të shumta e që nuk mund t’i përmendim të gjitha në këtë kërkim të shkurtër. Ai që dëshiron më shumë, le të kthehet tek librat e botuar për këtë temë.<sup>17</sup>

<sup>14</sup> *El-Gadijr* i ‘Al’lame Eminut, 2:52 siç është përmendur tek vargjet e *Feraidu’s-Simtejn*, 1: 189-190. *El-Menakib* i Khauarizmiut, 186. *Tedhkiiretu’l-Khauass* i Ibn Xheuziut, 15. *Kifajetu’t-Talib*, 228 me shprehje të tjera.

<sup>15</sup> Surja “Esh-Shu’ara”, ajeti 214.

<sup>16</sup> *Tarijkhu’t-Tabarij*, 2: 217. *Es-Sijretu’l-Halebije* i Ali ibn Ibrahim El-Halebijj’sh-Shafi’ij, 1: 286, Daru Ihjai’t-Turathi’l-Arabij, El-Mektebetul Islamije, Bejrut. *Me’alimu’t-Tenzijl* i Bagavijut, 4: 278. *Sherh Ibn Ebi’l-Hadijd*, 13: 210. *Kenzu’l-Ummal*, 13: 131/36496.

<sup>17</sup> Shih: *Shevahidu’t-Tenzijl* i Hakim El-Hasekanit, *Tefsijru’l-Hibrij* dhe *Khasaisu’l-Uahji’l-Mubijn* i Ibn Batrijikut.

